



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë), nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas një denoncimi të dorëzuar nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK), në vazhdimin e seancës së tij të 84-të të mbajtur më 31.03.2023, vendosi si më poshtë:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-4186/1 të datës 09.12.2020, e formuar sipas denoncimit të dorëzuar për personin zyrtar -----, ish kryetar i Komunës -----, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm sipas lëndës për rastin e lëndës tashmë është vepruar nga organe tjera kompetente.

Lënda me numër 12-4186/1 të datës 09.12.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në formë të depersonalizuar në afat prej 5 (pes) ditëve..

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, personi ----- - këshilltar për menaxhim me burime njerëzore në Komunën ----- më datë 09.12.2020, është dorëzuar denoncim për personin -----, ish kryetar në Komunën ----- dhe është formuar lënda me numër 12-4186/1 të datës 09.12.2020.

Pohimet në denoncim kanë të bëjnë me atë se udhëheqësi i tij, ish kryetar në Komunën ----- mori kërkesë me gojë për të përpiluar Aktvendim për kryerje të detyrës realizues të detyrës drejtor në NPK „-----“ nga -----, me urdhër për personin që duhet të jetë i emëruar. Pas kësaj parashtruesi i denoncimi t e informoi tashmë ish kryetarin e Komunës se miratimi i këtij Aktvendimi është kundër ligjore dhe ka mundësi që e njëjta të paraqet vepër penale për arsye se aktvendimi për shkarkimin e drejtoreshës së më parshme me të cilën ajo ka refuzuar ta pranon të njëjtën. Sipas parashtruesit të denoncimit në përputhje me Ligjin për procedurë të

përgjithshme juridike, procedura duhet të përsëritej për dorëzimin e aktvendimit për shkarkim për her të dit, para se të ekziston mundësi ligjore të miratohet aktvendimi me të cilën do të emërohet drejtori i ri U.D Drejtor

Parashtruesi i denoncimit thekson se duke vepruar sipas nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për punonjësit në sektorin publik i ka njoftuar organet kompetente gjegjësisht Ministrin për vetëqeverisje lokale, Inspektoratin administrativ shtetërorë dhe KSHPK-në.

Për arsye të kontrollit të pohimeve në denoncim dhe përcaktimin e gjendjes faktike, KSHPK-ja dorëzoi kërkesë për grumbullimin e informacioneve në inspektorin administrativ shtetërorë me qëllim sigurimin e informacionit për atë nëse është formuar lëndë me pohimet nga denoncimi dhe nëse sipas të njëjtave është vepruar.

Në afatin e paraparë ligjor, janë pranuar informacionet e kërkuar dhe nga këqyrja në dokumentacionin e marrë mund të konstatohet se Inspektorati administrativ shtetërorë ka vepruar sipas shkresës së pranuar nga personi zyrtar - këshilltar për menaxhim me burime njerëzore në Komunën ----- dhe nga studimi i shkresave të dorëzuar në shtojcë të cilët kanë të bëjnë me miratimin e aktvendimit për drejtoreshën aktuale të NPK e cila refuzoi që ta pranonte të njëjtën, konstatuan se në përputhje me nenin 83 paragrafi 3 të LPSP, nëse marrësi refuzon ta pranojë atë dhe nënshkruan flete dorëzimin, nëpunësi do të vërë re refuzimin dhe dorëzimi do të konsiderohet se është kryer siç duhet. Më tej, thuhet se lidhur me shkarkimin e drejtorit të NPK-së, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i komunave zgjedh dhe shkarkon drejtorët e shërbimeve publike të themeluara nga komuna.

Në lidhje me të konstatuarën. Inspektorati administrativ shtetëror e njoftoi parashtruesin e shkresës më datë 16.12.2020.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent sipas lëndës dhe sipas rastit të lëndës tashmë është vepruar nga organe tjera kompetente dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:
- parashtruesi i denoncimit

Përpiloi: Mr. K.z
Miratoi: Mr. V.G anëtar i KSHPK-së

**КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
НЁНКРЈЕТАР,
Катика Николовска**

